



**Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

SHËRBIME MJETESH TRANSPORTI

Niveli IV në KSHK¹, referuar nivelit IV të KEK²

M-IV-23

Tiranë, 2023

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Emërtimi i kualifikimit	SHËRBIME MJETESH TRANSPORTI			Kodi
Kohëzgjatja	900 - 1100 orë	Niveli	IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK	M-IV-23
Qëllimi:	Qëllimi kryesor i arsimit profesional në kualifikimin profesional “Shërbime mjetesh transporti”, niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, është të përgatisë teknik/menaxher të mesëm në fushën e Shërbimeve të Mjeteve të Transportit dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtari bazë për riparimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve të transportit, kontrollin, shitjen e tyre në një biznes të mjeteve të transportit apo për krijimin e një biznesi privat.			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	<p>Në shkollat që ofrojnë arsim profesional në kualifikimin profesional “Shërbime mjetesh transporti”, niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kanë mbaruar arsimin profesional në një nga kualifikimet profesionale përkatëse të “Shërbime mjetesh transporti”, niveli III në KSHK; - janë në kushte shëndetësore të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional. 			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	<p>Përfundimi me sukses i arsimit profesional në kualifikimin profesional “Shërbime mjetesh transporti”, niveli i IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, e pajis individin me Certifikatën Profesionale të Nivelit dhe Supplementin përkatës të saj të këtij niveli, si teknik/menaxher i mesëm në këtë kualifikim profesional, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p>Ky arsimim i jep mundësi individit t’i drejtohet tregut të punës për t’u punësuar në subjekte të ndryshme private/shtetërore që ushtrojnë aktivitet në mirëmbajtjen, riparimin, kontrollin teknik të mjeteve të transportit, në fushën e tregtisë së pjesëve të këmbimit dhe shitjes së mjeteve të transportit. Gjithashtu, individi mund të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi individual në fushën e shërbimeve të mjeteve të transportit.</p> <p>Me përfundimin e këtij niveli, individi fiton të drejtën e diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare.</p>			
Data validimi	Korrik 2023			
Data e miratimit				
Variantet e mëparshme	M-IV-15			

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Rezultatet e të nxënit në:

NJOHURI PROFESIONALE

Në përfundim të kualifikimit profesional "Shërbime mjetesh transporti" niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, individi zotëron njohuritë profesionale të ndara sipas fushave të mëposhtme:

Planifikimi dhe organizimi i punës

- Të përshkruajë organigramën e një servisi (ndërmarrjeje) në shërbimet e mjeteve të transportit;
- Të shpjegojë rëndësinë e ndarjes së detyrave sipas posteve në shërbimet e mjeteve të transportit;
- Të shpjegojë rëndësinë e organizimit të punës, rolin dhe qëllimin e tij, në funksionimin e një biznesi të shërbimeve të mjeteve të transportit;
- Të përshkruajë përdorimin e veglave, pajisjeve, makinerive dhe instrumenteve matëse e kontrolluese të një servisi për shërbime mjetesh transporti;
- Të shpjegojë rëndësinë e pastrimit dhe sistemimit të vendit të punës;
- Të analizojë një plan pune me detyrat përkatëse për riparimin e një mjeti transporti;
- Të përshkruajë domosdoshmërinë e përshtatjes për situata të ndryshme dhe marrjen e vendimeve të duhura;
- Të shpjegojë domosdoshmërinë e kontrollit dhe mënyrën e funksionimit të pajisjeve individuale dhe kolektive të sigurisë;
- Të përshkruajë mënyrën e hartimit të urdhrave të punës sipas proceseve të punës.

Diagnostikim i parregullsive në mjetet e transportit

- Të argumentojë rëndësinë e përdorimit të informacionit për lloje të ndryshme të mjeteve me specifikat e tyre përkatëse;
- Të përshkruajë llojet e dokumentacionit teknik që përdoren për diagnostikimin e parregullsive në mjetet e transportit;
- Të argumentojë mënyrat e diagnostikimit të parregullsive në mjetet e transportit për përcaktimin e mënyrës së riparimit;
- Të përshkruajë veglat, mjetet, si dhe instrumentet matëse dhe kontrolluese për diagnostikimin e parregullsive në mjetet e transportit;
- Të përshkruajë llojet e matjeve dhe të testeve për diagnostikimin e parregullsive në mjetet e transportit;
- Të përshkruajë parregullsitë kryesore në sistemet, mekanizmat dhe agregatet e mjeteve të transportit;
- Të përshkruajë punimet diagnostikuese në sistemet e motorëve të mjeteve të transportit;
- Të përshkruajë punimet diagnostikuese në sistemin e transmetimit të fuqisë në mjetet e

transportit;

- Të përshkruajë punimet diagnostikuese në sistemet e përditësuara të embrojtjes së mjedisit të mjeteve të transportit;
- Të përshkruajë punimet diagnostikuese në sistemet e përditësuara për sigurinë e lëvizjes, sigurinë fizike dhe orientimin e mjeteve të transportit;
- Të përshkruajë punimet diagnostikuese në karrocerinë e mjeteve të transportit;
- Të përshkruajë punimet diagnostikuese në mjetet e rënda të transportit;
- Të përshkruajë punimet diagnostikuese në makinat bujqësore;
- Të argumentojë rëndësinë e konsultimit me specialistë të tjerë për diagnostikimin e parregullsive në mjetet e transportit;
- Të argumentojë rëndësinë e përdorimit të katalogëve për përzgjedhjen e materialeve dhe pjesëve të këmbimit;
- Të përshkruajë rëndësinë e informimit të klientit për koston dhe kohën e riparimit, pas diagnostikimit të parregullsive në mjet.

Riparim dhe mirëmbajtje në mjetet e transportit

- Të përshkruajë proceset e riparimit dhe mirëmbajtjes së automjetit;
- Të shpjegojë rëndësinë e koordinimit me specialistët përkatës për mirëmbajtjen dhe riparimin e mjeteve të transportit;
- Të përshkruajë mënyrat e vendosjes dhe largimit të mjetit nga posti i punës;
- Të shpjegojë rëndësinë e kryerjes në kohë të shërbimeve;
- Të përshkruajë llojet e shërbimeve në sistemet e motorëve të mjeteve të transportit;
- Të përshkruajë llojet e shërbimeve në sistemin e transmetimit të fuqisë në mjetet e transportit;
- Të përshkruajë llojet e shërbimeve në sistemin elektrik dhe elektronike në mjetet e transportit;
- Të përshkruajë llojet e shërbimeve në sistemet e përditësuara të mbrojtjes së mjedisit të mjeteve të transportit;
- Të përshkruajë llojet e shërbimeve në sistemet e përditësuara për sigurinë e lëvizjes, sigurinë fizike dhe orientimin e mjeteve të transportit;
- Të përshkruajë llojet e shërbimeve në karroceri në mjetet e transportit;
- Të përshkruajë llojet e shërbimeve në mjetet e rënda të transportit;
- Të përshkruajë llojet e shërbimeve në makinat bujqësore;
- Të listojë proceset e mirëmbajtjes së automjetit bazuar në rekomandimet e prodhuesit.

Kontrolli i cilësisë së punimeve

- Të argumentojë rëndësinë e informimit gjatë dhe pas përfundimit të procesit të riparimit të mjeteve të transportit;
- Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të teknikave dhe mjeteve për kontrollin e cilësisë së punimeve të kryera në mjetet e transportit;
- Të përshkruajë rëndësinë e kontrollit të përputhshmërisë së pjesëve të këmbimit me specifikimet teknike të kërkuara për mjetet e transportit;

- Të argumentojë zbatimin e procedurave të duhura për riparimin e mjeteve të transportit;
- Të argumentojë rëndësinë e zbatimit të procedurave dhe mënyrave të kontrollit dhe testimit të mjetit pas riparimit;
- Të shpjegojë parregullsitë e punimeve pas riparimit dhe të marrë masa për korrigjimin e tyre;
- Të përshkruajë llojet e dokumentacionit teknik për kontrollin e cilësisë së punimeve të kryera në mjetet e transportit.

Mirëmbajtja e servisit

- Të përshkruajë mënyrat e mirëmbajtjes së makinerive dhe pajisjeve të punës;
- Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të kalendarit të shërbimeve të makinerive dhe pajisjeve të punës;
- Të shpjegojë mënyrën e plotësimit të librit të shërbimit të makinerive dhe pajisjeve të punës;
- Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të kalendarit të kolaudimeve periodike të makinerive dhe pajisjeve të punës;
- Të shpjegojë rëndësinë e kalibrimit të makinerive dhe pajisjeve të punës;
- Të shpjegojë rëndësinë e informimit të specialistëve për parregullsi në makineritë dhe pajisjet e punës;
- Të përshkruajë mënyrat e organizimit të punës në rast defektesh në ambientet e servisit.

Detyra administrative dhe tregtare

- Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të kodit të punës, legjislacionit tatimor dhe legjislacionin që lidhet me aktivitetin;
- Të shpjegojë mënyrën e përgatitjes dhe të plotësimit të dokumentacionit teknik në një biznes të shërbimeve të mjeteve të transportit;
- Të përshkruajë nevojën e hartimit të një preventivi në një biznes në mjetet e transporti;
- Të shpjegojë mënyrën e përgatitjes së planeve ditore, javore, mujore të punës;
- Të përshkruajë përdorimet e programeve kompjuterike, katalogëve dhe manualeve për shërbimet e mjeteve të transportit;
- Të përshkruajë mënyrën e llogaritjes së kostos së materialeve të punës, pjesëve të këmbimit dhe shërbimeve të kryera;
- Të përshkruajë mënyrën e hartimit të ofertës lidhur me punimet/shërbimet ndaj klientit;
- Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të grafikut të kohës për punimet e kryera;
- Të shpjegojë rëndësinë e raportimit të punës së kryer te eprorët.

Komunikimi dhe etika profesionale

- Të përshkruajë rëndësinë e shkëmbimit të informacionit për problemet dhe të rejat e ditës;
- Të shpjegojë parimet kryesore të punës në grup dhe rëndësinë e zbatimit të tyre;
- Të listojë rregullat bazë të komunikimit verbal dhe jo verbal me eprorët dhe kolegët;
- Të shpjegojë domosdoshmërinë e respektimit të hierarkisë;

- Të shpjegojë parimet bazë të kodit të etikës në punë;
- Të shpjegojë rëndësinë e komunikimit në mënyrë etike dhe profesionale me kolegët dhe eprorët;
- Të listojë metodat e zgjidhjes së problemeve dhe mendimit kritik;
- Të shpjegojë mënyrën e trajtimit të ankesave me klientët me etikë profesionale;
- Të përshkruajë rolin e bashkëpunëtorëve në veprimtarinë profesionale;
- Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të teknologjisë së informimit dhe komunikimit;
- Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të terminologjisë teknike dhe profesionale gjatë punimeve në servis;
- Të shpjegojë rëndësinë e respektimit të barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj;
- Të përshkruajë rëndësinë e koordinimit dhe rregullat e komunikimit me teknikët e specialistët e tjerë.

Rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtja e mjedisit

- Të përshkruajë rëndësinë e standardeve dhe legjislacionit shqiptar për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik;
- Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të standardeve ndërkombëtare;
- Të shpjegojë përdorimin e manualeve të makinerive, mjeteve dhe pajisjeve të punës;
- Të argumentojë përdorimin e sinjalistikës (udhëzimet, shenjat dhe simbolet e shkruara) në mjedisin e punës;
- Të shpjegojë hapat e zbatimit të procedurave për evakuim në raste emergjence;
- Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të pajisjeve të mbrojtjes dhe shpëtimit ndaj zjarrit;
- Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të llojeve të mjeteve dhe veprimet e nevojshme për ndihmën e parë;
- Të përshkruajë rregullat e sigurisë dhe shëndetit në punë gjatë kryerjes së punimeve me solucione me përmbajtje kimike sipas llojit të solucionit;
- Të shpjegojë përdorimin e veshjeve dhe pajisjeve mbrojtëse individuale dhe kolektive në punë;
- Të përshkruajë rreziqet kryesore të ndotjes së ambientit dhe masat përkatëse për eliminimin e tyre gjatë kryerjes së shërbimeve në mjetet e transportit;
- Të përshkruajë procedurat e duhura për ndarjen e mbetjeve sipas llojit dhe depozitim të mbetjeve nga procesi i punës në përputhje me rregulloren e mjedisit;
- Të përshkruajë rregullat e sigurisë për ruajtjen dhe magazinimin e materialeve që rrezikojnë ndotjen e mjedisit;
- Të shpjegojë rëndësinë e instruktimit periodik të punonjësve për rregullat e sigurimit teknik;
- Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit racional të lëndëve të para, pjesëve të këmbimit dhe të energjisë;

- Të përshkruajë zbatimin e protokolleve të duhura në raste pandemie.

Sipërmarrje dhe edukim karriere

- Të listojë llojet e dokumenteve që përdorën në fushën e shërbimeve të mjeteve të transportit;
- Të përshkruajë mënyrën e arkivimit të dokumentacionit teknik;
- Të përshkruajë mënyrën e regjistrimit të të dhënave për përgatitjen e një oferte;
- Të listojë llojet e faturave dhe mënyrën e plotësimit të tyre;
- Të përshkruajë format e pagesave të përdorura në marrëdhëniet me palët e tjera në një transaksion ekonomik dhe nevojën e dokumentimit të tyre;
- Të argumentojë rëndësinë e kontrollit të çmimeve të tregut;
- Të listojë teknikat e ndryshme të marketingut;
- Të analizojë interesat, aftësitë personale përmes mënyrave të ndryshme përfshirë vetvlerësimin;
- Të analizojë format e ndryshme të sipërmarrjes në lidhje me synimet kryesore të karrierës personale, mundësitë dhe përfitimet në komunitet;
- Të përshkruajë teknologjitë bashkëkohore për proceset e punës në fushën e shërbimit të mjeteve të transportit;
- Të listojë mënyrat e transmetimit në kohë tek bashkëpunëtorët të njohurive dhe aplikimin e teknikave të reja në punë;
- Të shpjegojë domosdoshmërinë e përdorimit të literaturës bashkëkohore;
- Të shpjegojë domosdoshmërinë e pjesëmarrjes në panairë dhe ekspozita;
- Të argumentojë rëndësinë e ndjekjes së trajnimeve profesionale.

SHPREHI PROFESIONALE

Individi duhet të jetë i aftë:

Planifikimi dhe organizimi i punës

- Të organizojë punën në një servis për shërbime mjetesh transporti;
- Të përdorë veglat e punës, pajisjet, makineritë, si dhe instrumentet matëse dhe kontrolluese të një servisi për shërbime mjetesh transporti;
- Të ndajë detyrat tek personeli në një servis për shërbime mjetesh transporti;
- Të bëjë një plan pune për riparimin e një mjeti transporti;
- Të sigurohet për funksionalitetin e veglave të punës, pajisjeve dhe makinerive;
- Të furnizojë me bazë materiale servisin për shërbime mjetesh transporti;
- Të mbikëqyrë pastrimin dhe sistemimin e veglave dhe vendit të punës;
- Të hartojë një urdhër pune sipas posteve përkatëse në një servis;
- Të marrë vendimet e duhura për situata të ndryshme;
- Të kontrollojë funksionimin e pajisjeve individuale dhe kolektive të sigurisë.

Diagnostikimi i parregullsive në mjetet e transportit

- Të përdorë informacionin për lloje të ndryshme të mjeteve me specifikat e tyre përkatëse;
- Të përdorë llojet e dokumentacionit teknik që përdoren për diagnostikimin e parregullsive në mjetet e transportit;
- Të zbatojë mënyrat e diagnostikimit të parregullsive në mjetet e transportit për përcaktimin e mënyrës së riparimit;
- Të përdorë veglat, mjetet dhe instrumentet matëse dhe kontrolluese për diagnostikimin e parregullsive në mjetet e transportit;
- Të kryejë matje dhe testime të ndryshme për diagnostikimin e parregullsive në mjetet e transportit;
- Të diagnostikojë parregullsitë në sistemet, mekanizmat dhe agregatet e mjeteve të transportit;
- Të realizojë punimet diagnostikuese në sistemet e motorëve të mjeteve të transportit;
- Të realizojë punimet diagnostikuese në sistemin e transmetimit të fuqisë në mjetet e transportit;
- Të realizojë punimet diagnostikuese në sistemet e përditësuara të mbrojtjes së mjedisit të mjeteve të transportit;
- Të realizojë punimet diagnostikuese në sistemet e përditësuara për sigurinë e lëvizjes, sigurinë fizike dhe orientimin e mjeteve të transportit;
- Të realizojë punimet diagnostikuese në karrocerinë e mjeteve të transportit;
- Të realizojë punimet diagnostikuese në mjetet e rënda të transportit;
- Të realizojë punimet diagnostikuese në makinat bujqësore;
- Të konsultohet me specialistë të tjerë për diagnostikimin e parregullsive në mjetet e transportit;
- Të përdorë katalogë të ndryshëm për përzgjedhjen e materialeve dhe pjesëve të këmbimit;
- Të informojë klientin për koston dhe kohën e riparimit, pas diagnostikimit të parregullsive.

Riparim dhe mirëmbajtje në mjetet e transportit

- Të mbikëqyrë proceset e riparimit dhe mirëmbajtjes së automjetit;
- Të koordinojë proceset e riparimit dhe mirëmbajtjes me specialistët përkatës;
- Të mbikëqyrë mënyrat e vendosjes dhe largimit të mjetit nga posti i punës;
- Të mbikëqyrë kryerjen në kohë të shërbimeve;
- Të mbikëqyrë shërbimet në sistemin e motorëve të mjeteve të transportit;
- Të mbikëqyrë shërbimet në sistemin e transmetimit të fuqisë në mjetet e transportit;
- Të mbikëqyrë shërbimet në sistemin elektrik dhe elektronike në mjetet e transportit;
- Të mbikëqyrë shërbimet në sistemet e përditësuara të mbrojtjes së mjedisit të mjeteve të transportit;
- Të mbikëqyrë shërbimet në sistemet e përditësuara për sigurinë e lëvizjes, sigurinë fizike dhe orientimin e mjeteve të transportit
- Të mbikëqyrë shërbimet në karroceri në mjetet e transportit;

- Të mbikëqyrë shërbimet në mjetet e rënda të transportit;
- Të mbikëqyrë shërbimet në makinat bujqësore;
- Të kryejë mirëmbajtjen e automjetit bazuar në rekomandimet e prodhuesit.

Kontrolli i cilësisë së punimeve

- Të informohet gjatë dhe pas përfundimit të procesit të riparimit të mjeteve të transportit;
- Të përdorë teknikat dhe mjetet e duhura për kontrollin e cilësisë së punimeve të kryera në mjetet e transportit;
- Të kontrollojë përputhshmërinë e pjesëve të këmbimit me specifikimet teknike të kërkuara për mjetet e transportit;
- Të zbatojë procedurat e duhura për riparimin e mjeteve të transportit;
- Të zbatojë procedurat e duhura për kontrollin dhe testimin e mjetit pas riparimit;
- Të marrë masa për korigjimin e parregullsive pas riparimit të mjetit;
- Të përdorë dokumentacionin teknik për kontrollin e cilësisë së punimeve të kryera në mjetet e transportit.

Mirëmbajtja e servisit

- Të informohet për mirëmbajtjen e pajisjeve dhe makinerive të servisit;
- Të zbatojë kalendarin e shërbimeve të pajisjeve dhe makinerive të servisit;
- Të plotësojë librin e shërbimeve të pajisjeve dhe makinerive të servisit;
- Të monitorojë kalendarin e kolaudimeve periodike në pajisjet dhe makineritë e punës;
- Të monitorojë pajisjet dhe makineritë e punës lidhur me nevojën për kalibrim;
- Të bashkëpunojë me specialistët e tjerë për parregullsi në pajisjet dhe makineritë e punës;
- Të organizojë punën në rast defektesh në ambientet e servisit.

Detyra administrative dhe tregtare

- Të zbatojë kodin e punës, legjislacionin tatimor dhe legjislacionin që lidhet me aktivitetin;
- Të përgatisë dokumentacionin teknik në një biznes të shërbimeve të mjeteve të transportit;
- Të përgatisë plane ditore, javore, mujore të punës;
- Të përdorë programet kompjuterike, katalogë dhe manuale për shërbimet e mjeteve të transportit;
- Të llogarisë koston e materialeve të punës, pjesëve të këmbimit dhe shërbimeve të kryera;
- Të hartojë oferta lidhur me punime/shërbime ndaj klientit;
- Të zbatojë grafikun e punimeve që do të kryhen;
- Të hartojë dokumentacionin për garancinë e punimeve të kryera sipas standardeve teknike;
- Të marrë pjesë rregullisht në përgatitjen e raporteve periodike për aktivitetet e zbatuara;

- Të hartojë raporte periodike për shërbimet e kryera.

Komunikimi dhe etika profesionale

- Të shkëmbejë informacion për problemet dhe të rejtat e ditës;
- Të vlerësojë punën në grup;
- Të zbatojë rregullat bazë të komunikimit verbal dhe jo verbal me eprorët dhe kolegët;
- Të respektojë hierarkinë;
- Të zbatojë kodin e etikës në punë;
- Të komunikojë në mënyrë etike dhe profesionale me kolegët dhe eprorët;
- Të zgjidhë ankesat me klientët me etikë profesionale;
- Të këmbëjë udhëzime/procedura me bashkëpunëtorët në veprimtarinë profesionale;
- Të përdorë teknologji të reja të informimit dhe komunikimit;
- Të përdorë terminologji teknike dhe profesionale gjatë punimeve në servis;
- Të zbatojë parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj..

Rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtja e mjedisit

- Të zbatojë standardet kombëtare, ndërkombëtare dhe legjisllacionin në fuqi për rregullat e sigurimit teknik;
- Të përdorë manualët e sigurisë në punë gjatë përdorimit të mjeteve, pajisjeve dhe makinerive të punës;
- Të zbatojë sinjalistikën (udhëzimet, shenjat dhe simbolet e shkruara) në mjedisin e punës;
- Të zbatojë procedurat për evakuim në raste emergjence;
- Të përdorë pajisjet e mbrojtjes dhe shpëtimit ndaj zjarrit;
- Të japë ndihmën e parë në rast nevojë;
- Të zbatojë rregullat e sigurisë dhe shëndetit në punë gjatë kryerjes së punimeve me solucione me përmbajtje kimike;
- Të përdorë veshjet dhe pajisjet mbrojtëse individuale dhe kolektive në punë;
- Të marrë masa për eliminimin e rreziqeve të ndotjes së ambientit;
- Të realizojë procedurat e duhura për ndarjen dhe depozitimin e mbetjeve sipas llojit në përputhje me rregulloren e mbrojtjes së mjedisit;
- Të zbatojë rregullat e sigurisë për ruajtjen dhe magazinimin e materialeve që rrezikojnë ndotjen e mjedisit;
- Të realizojë instruktimin periodik të punonjësve për rregullat e sigurimit teknik;
- Të përdorë në mënyrë racionale energjinë, lëndët e para, veglat e punës dhe pjesët e këmbimit;
- Të zbatojë protokollat e duhura në raste pandemie.

Sipërmarrje dhe edukim karriere

- Të përgatisë dokumentet që përdoren në fushën e shërbimeve të mjeteve të transportit;

- Të kryejë ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit teknik;
- Të regjistrojë ofertat dhe faturat për shërbimet e kryera;
- Të përcaktojë mënyrën e pagesës për shërbimet e kryera;
- Të kryejë veprime me institucionet financiare;
- Të kontrollojë çmimet e tregut në fushën e shërbimeve të mjeteve të transportit;
- Të përzgjedhë mjetet dhe strategjitë e marketingut;
- Të përcaktojë interesat, aftësitë personale përmes mënyrave të ndryshme përfshirë vetvlerësimin;
- Të përzgjedhë format e ndryshme të sipërmarrjes në lidhje me synimet e karrierës personale;
- Të përdorë teknologjinë bashkëkohore për proceset e punës;
- Të përditësoj njohuritë për aplikimin e teknikave të reja në punë;
- Të përdorë literaturë bashkëkohore në fushën e shërbimeve të mjeteve të transportit;
- Të marrë pjesë në panairë dhe ekspozita;
- Të kryejë trajnime të vazhdueshëm sipas nevojës për rritje profesionale.

KOMPETENCA TE PERGJITHSHME

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme kulturore, sociale, ligjore, organizative e tekniko-profesionale.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional dhe t'i shpërndajë ato, në dobi të kolegëve dhe punonjësve në njësisë e tij/saj prodhuese.
- Të nxisë potencialin e tij/saj të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente.
- Të ndër marrë apo hedhë vazhdimisht ide të reja, duke hartuar projekte të reja, struktura të reja organizative, të cilat sjellin përmirësimin e strukturave ekzistuese.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij/saj.
- Të tregojë vetkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij/saj.
- Të demonstrojë maturi me eprorët, vartësit, partneret, etj.;
- Të organizojë drejt procesin e të nxënimit të tij/saj dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë aftësitë e tij/saj, nisur nga kritere të drejta, si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij/saj.
- Të jetë i hapur dhe të veprojë si një ndërlidhës midis njësisë së tij prodhuese dhe

njësive të tjera brenda ndërmarrjes apo ndërmjet ndërmarrjes dhe të tretëve jashtë saj, si furnitorët, klientët, partneret, etj., duke ndihmuar në realizimin e qëllimeve të njësive prodhuese.

- Të demonstrojë aftësi për të përmbushur detyrat brenda afateve sipas një plani të caktuar.
- Të marrë nisma për të bashkëpunuar me individë apo grupe.
- Të demonstrojë sjellje të përgjegjshme dhe etike në veprimtari shkollore dhe komunitet.
- Të demonstrojë aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për qenë pjesëmarrës proaktiv në grup.
- Të demonstrojë përgjegjshmëri ndaj mjedisit dhe të mirave publike.
- Të pranojë dhe të promovojë risitë dhe ndryshimet.
- Të demonstrojë marrjen e nismave për të zhvilluar dhe zbatuar një ide.
- Të demonstrojë zotësi për të nxënë nga dështimet dhe për të këmbëngulur drejt arritjes së synimeve të tij/saj.
- Të aplikojë mënyra konstruktive të përgjigjeve ndaj kritikave.
-